




REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA VUSHTRRI – OPSTINA VUCITRN



Drejtoria Komunale për Prokurim Publik
14 Nr. 474/20
Dt. 07.09.2020

Duke vendosur në çështjen administrative, sipas Kërkesës për Rishqyrtim të Op. Ek. “ Sallahu ”sh.p.k. me seli në Kaçanik, kundër Njoftimit për Kontratë të dt. 24.08.2020 të Autoritetit Kontraktues – Drejtorisë Komunale për Prokurim Publik, pas mbajtjes së seancës jo publike të shqyrtimit të Kërkesës për Rishqyrtim të Op. Ek. në fjalë, në bazë të nenit 108/A pika 10 paragrafi 10.2 të Ligjit për Prokurimin Publik në Kosovë nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 dhe nenin 8 pika 8.1.2 paragrafi i të Rregullave për paraqitje të Kërkesës për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues, më datën **07.09.2020** bie këtë:

V E N D I M

- 1. Apropohet** pjesërisht si e bazuar Kërkesa për rishqyrtim, e subjektit në procedurë : “ Sallahu ”sh.p.k. me seli në Kaçanik, e datës 28.08.2020, për rishikimin - rivlerësimin e aktivitetit të prokurimit kundër Njoftimit për Kontratë të Autoritetit Kontraktues të datës 24.08.2020 lidhur me aktivitetin e prokurimit : “ **Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatrat sipas Lot. 1 dhe 2** “ me nr. të prokurimit : **644 – 20 – 4423 – 511 dhe Nr. i brendshëm : 644 – 20 – 050 – 511.**
- 2.** Autoritetit Kontraktues – Drejtoria Komunale për Prokurim Publik, në pajtim me dispozitat e nenit 108/1 paragrafi 10.2 të LPP-së dhe nenin 8 pika 8.1.2 paragrafi i të Rregullave për paraqitje të Kërkesës për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues do të ndërmarr veprimet procedurale në pajtim me këtë vendim.
- 3.** Vendimi hynë në fuqi ditën e marrjes.

A r s y e t i m

Autoriteti Kontraktues – Drejtoria Komunale për Prokurim Publik ka publikuar Njoftimin për Kontratë për aktivitetin e prokurimit : “ **Asfaltimi i rrugëve lokale në fshatrat sipas Lot. 1 dhe 2** “ me nr. të prokurimit : **644 – 20 – 4423 – 511 dhe Nr. i brendshëm : 644 – 20 – 050 – 511**

Në Kërkesën për rishqyrtim të vendimit të A.K., e parashtruar nga Op. Ek. “ Sallahu ”sh.p.k. me seli në Kaçanik, e cila është parashtruar brenda afatit të paraparë ligjore, Op. Ek. konsideron se Specifikat Teknike të disa prej pajisjeve teknike të saktësuara në FTD nuk janë në pajtim me natyrën e aktivitetit të prokurimit dhe si të tilla paraqesin kufizim të pjesëmarrjes së O.E. në aktivitetin e prokurimit në fjalë, me theks të veçantë s ai përket Specifikave të “ Bager “ 65 deri në 70 tonë dhe “ Bulldozher “ 8-12 tonë. Pasi u shqyrtuan pretendimet e Op. Ek. të dhëna në Kërkesën për Rishqyrtim, duke marrë për bazë dhe rekomandimin e Njësisë kërkuese lidhur me korrigjimin e Specifikave Teknike të pajisjeve teknike në fjalë, A.K. konstaton se Kërkesa për Rishqyrtim e Op. Ek. është pjesërisht e bazuar, për arsye se Autoriteti Kontraktues, tek pajisjet teknike në fjalë : “ Bager “ dhe “ Bulldozher “ do të saktësoi vetëm peshën min. prej 65 tonë tek “ Bageri “ përkatësisht 8 tonë tek “ Bulldozheri “ ndërsa pesha maksimale nuk është e kufizuar që donë të thotë se O.E. mundë të dëshmon pajisjet në fjalë edhe me pesha më të larta se ato minimale. Po ashtu e njëjta zgjidhje vendoset edhe sa i takon “ Eskavator “ me peshë min 7 tonë ndërsa O.E. mundë të dëshmoi pajisje të kërkuar edhe me peshë më të lartë. Zgjedhjet si më lartë A.K. do ti ngritë edhe përmes Platformës Elektronike, me qëllim të informimit të të gjithë O.E. të interesuar për pjesëmarrje në këtë aktivitet të prokurimit.

Nga sa u tha me lartë, e në përputhje me nenin 108/A paragrafi 10.2 të Ligjit për Prokurimin Publik në Kosovë nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, lidhur me nenin 8 pika 8.1.2 paragrafi i të Rregullave për paraqitje të Kërkesës për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues është vendosur si në dispozitiv te këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë Vendim ka të drjtë të parashtroi Ankesë pranë Organit Shqyrtues për Prokurim – OSHP-së, në pajtim me nenin 109 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Autoriteti Kontraktues – Komuna e Vushtrrisë
K.R.. nr. 050/2020, datë 07.09.2020

Aktvendimi i dërgohet:

1. Palës/ ve
2. DKP
3. Arkivit (1 kopje)

